

STATUTI

I

SINDIKATËS SË PUNONJËSVE

TË

POSTË -TELEKOMIT SHQIPTAR

KREU I PARË

EMRI, QËLLIMI DHE PARIMET E PËRGJITHSHME TË ORGANIZATËS

NENI 1

Bazat Ligjore

Ky statut bazohet ne Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7961, datë 12/07/1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Konventat ndërkombëtare të ILO-s te ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

NENI 2

Emërtimi i Organizatës

1. Emërtimi i organizatës sindikale do të jetë: Sindikata e Punonjësve të Post-Telekomit Shqiptar (SPPTSH). Vula e saj do të jetë e rrumbullakët, në të cilën shkruhet Sindikata e Poste-Telekomit - 1991.
2. Flamuri do to jetë bojëqielli, ne mes të të cilit është logoja e Sindikatës së Post-Telekomit
3. Adresa e Selisë do to jetë **Blv. “Bajram Curri”, Pall.116, nr.29, Apt. 5**, Tiranë Shqipëri.

NENI 3

Qëllimi dhe Parimet e Përgjithëshme

SPPTSH është një organizatë sindikale në të cilën aderjnë punonjësit e Albtelecomit, Makhesit, Postës Shqiptare, Qendrave te Thirjeve (Call Center) dhe është e hapur për të gjithë individët, sektorët privat dhe publik që i përkasin këtyre fushave apo profesioneve të tjera, si dhe sindikata të profesioneve që pranojnë këtë statut dhe shprehin dëshirën e anëtarësimit në këtë Sindikatë. Kjo organizatë ka si qëllim të dhe të organizojë punonjësit, pavarësisht nga përkatësia politike, etnia, raca, profesioni, gjinia apo bindja fetare. SPPTSH është kundër cdo lloj diskriminimi të lartpërmendur dhe kundër cdo organizate politike ose jo-politike me qëllime raciste dhe fashiste.

NENI 4

SPPTSH është një organizatë sindikale e ngritur mbi baza vullnetare, e cila ka si mision të mbrojë dhe të promovojë interesat e anëtarëve të saj, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për punën dhe të drejtat e njeriut. Kjo sindikatë merr pjesë në jetën social- kulturore që është më pranë interesave të punonjësve të saj dhe lufton për përmirësimin e jetës së anëtarëve të saj.

NENI 5

SPPTSH është person juridik i pavarur në kryerjen e veprimtarisë së saj sindikaliste. SPPTSH në gjithë veprimtarinë dhe punën e saj udhëhiqet nga vullneti i përbashkët i anëtarëve të organizatës. SPPTSH zbaton me rigorozitet standardet dhe normat demokratike në ndërtimin dhe funksionimin e strukturave të saj dhe në zgjedhjen e organeve drejtuese.

SPPTSH vepron nëpërmjet dialogut social, si dhe nëpërmjet veprimtarive sindikale të ndryshme në kuadrin e shtetit juridik. SPPTSH harton programin dhe veprimtarinë e vet bazuar në këtë Statut, dhe objektivat e sindikalizmit kombëtar, evropian dhe botëror, pjesë e të cilës ajo është.

NENI 6

SPPTSH bashkëpunon me të gjitha sindikatat dhe organizatat e tjera brenda dhe jashtë vendit, të cilat mbrojnë interesat e sindikatës përballë padrejtësive dhe paligjshmërisë.

NENI 7

Anëtarësia

Në Organizatën Sindikale mund të anëtarësohet çdo i punësuar në sektorin publik ose privat, punonjës që janë në asistencë ose perkohesisht të papunë, pavarësisht nga përkatësia partiake dhe bindjet politike ose fetare. Pranimi i individit në organizatë bëhet nëpërmjet deklaramit individual e me vullnet të lirë pranë Sindikatës dhe organeve të saj, nëpërmjet formularit të anëtarësimit, i cili plotësohet dhe depozitohet pranë Sekretariatit Organizativ ose strukturave të sindikates. Individit i interesuar për tu anëtarësuar në sindikatë mund të plotësojë paraprakisht formularin online në faqen e sindikates duke shprehur vullnetin e tij për të qenë anëtar i sindikates.

Anëtarësimi rregjistrohet në librin themeltar dhe në databazen elektronike të organizatës. SPPTSH depoziton formularët e anëtarësimit pranë punedhësit për mbajtjen e kuotizimit.

Anëtarët e SPPTSH-së kanë për detyrë:

- Të zbatojë Statutin dhe programin SPPTSH-së, si dhe legjislacionin ku është mbështetur ky statut.
- Të paguajë kuotizimin sindikalist. Kuota është subjekt ndryshimi në varësi të ndryshimeve ekonomike-financiare me miratimin paraprak të Këshillit Kombëtar.
- Të marrë pjesë në aksionet e lëvizjes Sindikaliste konform legjislacionit të punës të organizuara dhe vendosura nga Sindikata dhe organet drejtuese të saj.

Anëtarët kanë të drejtë:

- Të marrë pjesë në mbledhjet e organizatës sindikaliste dhe të shprehë lirshëm mendimin e tij.
- Të kërkojë zgjidhjen e padrejtësive në dëm të tij dhe realizimin e të drejtave të tij apo të organizatës ku ai bën pjesë.
- Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese të SPPTSH-së.

NENI 8

Heqja e anëtarësisë

Anëtaresimi është vullnetar. Ai pushon kur:

- a) nëpërmjet nënshkrimit të formularit për largimin nga Sindikata e SPPTSH-së dhe depozitimin e tij pranë Sekretarit Organizativ;
- b) shkelet rëndë statuti;
- c) me veprimet e tij anëtari dëmton imazhin e sindikatës
- d) shkakton dëme materiale ndaj Sindikatës
- e) refuzon të zbatojë vendimet e SPPTSH-së
- f) nuk paguan kuotën sindikale deri në 6 (gjashtë) muaj;

NENI 9

Këshilli Kombëtar i SPPTSH-së me pjesëmarrjen e mbi dy të tretave të anëtarëve të tij mund të marrë vendimin e përjashtimit të Seksionit/Rajonit/Filialit apo bën largimin nga detyra e funksionarit të zgjedhur ku ajo bën pjesë:

- a) kryen veprime në kundërshtim me statutin;
- b) refuzon të zbatojë vendimet e SPPTSH-së;
- c) refuzon të paguajë kuotizacionin e anëtarësisë në një afat kohor mbi 6 (gjashtë) muaj;
- d) dëmton imazhin dhe interesat e organizatës sindikale që e ka zgjedhur.

NENI 10

Burimi i të ardhurave

SPPTSH krijon fondin e saj me kuotat e grumbulluar nga anëtaresimet dhe nga cdo llojkontributi tjetër, që mund të rrjedhë nga marrëdhëniet kontraktuale të organizatës sindikale. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas nevojave të miratuara në buxhetin e Sindikatës, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar.

NENI 11

Struktura organizative e SPPTSH-së

SPPTSH është ndërtuar mbi bazën e funksionimit të seksioneve, rajoneve dhe filialeve në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Këshilli Kombëtar ka të drejtë të vendos mbi ndarjen dhe organizimin e seksioneve, rajoneve dhe filialeve dhe cdo ndryshim

NENI 12

Kryesia e seksionit, rajonit apo filialit përbëhet kryesisht nga kryetari, **zv/kryetari** dhe sekretari, të cilët janë përfaqësuesit e organizatës sindikale në këto struktura në raport me punëdhënësit. Këshilli Kombëtar ka të drejtë të vendos mbi kryesine e seksionit, rajonit apo filialit dhe cdo ndryshim miratohet me shumicë votash.

NENI 13

Përfaqësuesit e seksionit/rajonit/filialit zgjidhen me shumicë votash nga anëtarët e seksionit, rajonit ose filialit. Çdo anëtar i seksionit, rajonit ose filialit, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet në strukturat përkatëse. Në pamundësi të mbajtjes së zgjedhjeve nga rrethanat që mund të jenë krijuar, Këshilli Kombëtar mund të mandatojë përfaqësuesit e seksionit, rajonit ose filialit deri në mbajtjen e zgjedhjeve.

NENI 14

Përfaqësuesit japin llogari përpara mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të organizatës sindikale të seksionit, rajonit apo filialit. Mandati i përfaqësuesëve është pesë vjet. Ky mandat mund të revokohet në cdo kohë kur:

- a) ka raste të shkeljeve të rënda statutores;
- b) kur humbet votëbesimin e organizatës sindikale;
- c) kur ka rekomandim me vendim të Këshillit Kombëtar të SPPTSH-së;
- d) për arsye shëndetësore ose ne rast dorëheqjeje.

Të drejtën e vendimeve të mësipërme e kanë forumet që i kanë zgjedhur. Në rastin e kryetarit të SPPTSH-së që zgjidhet nga kongresi kerkohet kongresi i jashtzakonshem.

NENI 15

Kryesia e seksionit, rajonit ose filialit zakonisht mblidhet njëherë në 6 (gjashtë) muaj, ku analizon aktivitetin e kryer dhe merr vendime brenda kompetencave që i kanë deleguar dhe, në cdo rast, këto u bëhen të njohura anëtarëve të organizatës.

NENI 16

Përfaqësuesit e seksionit, rajonit ose filialit janë delegatë në kongresin e SPPTSH-së.

KREU I DYTE

ORGANET DREJTUESE, PERBERJA DHE FUNKSIONIMI I TYRE, KOHEZGJATJA E MANDATEVE

- KONGRESI
- KËSHILLI KOMBËTAR
- KRYESIA
- KRYETARI
- ZV/KRYETARI DHE SEKRETARI ORGANIZATIV
- PRESIDENTI NDERIT
- FORUMI I RINISË & FORUMI I GRUAS

NENI 17

Kongresi

1. Organi më i lartë i SPPTSH-së është Kongresi, i cili mblidhet në cdo 5 (pesë) vjet në vendin dhe datën që do të caktohet nga vendimi i Këshillit Kombëtar i SPPTSH-së dhe kur për këtë kanë votuar tre të katërtat e Këshillit Kombëtar. Kongresi mund të mblidhet dhe nga Kryetari i SPPTSH-së në raste të jashtëzakonshme, te tilla ne situatat që kalon ekonomia e vendit ose punëdhënësi. Kongresi mblidhet kur vdes Kryetari ose merr dënim nga një vendim i formës së prerë nga gjykata.
2. Shpallja e Kongresit të ri do të bëhet të paktën 60 ditë përpara datës së mbarimit të mandatit.
3. Delegatë në Kongres janë automatikisht përfaqësuesit e seksionit, rajonit, filialit dhe anëtarët e Këshillit Kombëtar. Numri i delegateve për cdo organizatë vendoset nga këshilli kombëtar i SPPTSH në funksion të:
 - a) Numrit të Antarëve të strukturës përkatëse duke ruajtur raportin 1 delegat për 10 anëtar.
 - b) Pagesës së kuotës nga organizata.
4. Mandati i delegatit është 5 (pesë) vjet. Mandati i Delegatit ndërpritet para kohe kur delegati jep dorëheqjen, ç'rregjistrohet ose largohet nga SPPTSH-së.

NENI 18

Detyrat e Kongresit

- a) Të degjojë, analizojë dhe miratojë raportin e përgatitur nga kryesia e SPPTSH-së për politikën e saj ekonomike dhe sociale të organizatës.
- b) Të përcaktojë programin dhe strategjitë e përgjithshme deri në Kongresin tjetër.
- c) Të zgjedhë Kryetarin e Sindikates të SPPTSH-s
- d) Të zgjedhë Presidentin e Nderit.
- e) Të aprovojë Këshillin Kombëtar.
- f) Të zgjedhë Komisionin e zgjidhjes së Konfliktëve dhe Verifikimit të Mandateve.
- g) Të zgjedhë Komisionin e Revizionit dhe Kontrollit.
- h) Të miratojë ndryshimet statutore.
- a) Të hartojë dhe miratojë rezolutën e Kongresit dhe rezoluta për çështje të veçantaë

lëvizjes sindikale.

Vendimmarrja ne Kongres: Kongresi i merr vendimet me shumice te thjeshte votash kur per keto kane votuar mbi 50%+1 e delegateve.

NENI 19

Këshilli Kombëtar

Këshilli Kombëtar i SPPTSH-së është organi më i lartë përfaqësues gjatë periudhës midis kongreseve dhe miratohet nga kongresi i rradhës me propozimin e Kryetarit të SPPTSH-së. Drejton të gjithë veprimtarinë e SPPTSH-ë për periudhën 5 (pesë) vjecare së bashku me organet ekzekutive të zgjedhura nga kongresi. Këshilli Kombëtar i SPPTSH-së raporton para Kongresit për veprimtarinë sindikale për periudhën nga Kongresi i mëparshëm.

Këshilli Kombëtar i SPPTSH-së është shprehje e ekuilibrit midis strukturave sindikale. Anëtarët e Këshillit Kombëtar janë kryesisht të gjithë të zgjedhurit në rolin e përfaqësuesve të seksioneve, rajoneve dhe filialeve sindikale të të gjitha niveleve që bëjnë pjesë në SPPTSH. Çdo anëtar i Këshillit Kombëtar është përfaqësues i sindikatës në Rajonin, Seksionin apo Filialin ku ai është zgjedhur. Çdo anëtar i Këshillit Kombëtar ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet në strukturat drejtuese të SPPTSH-së

Këshilli Kombëtar i SPPTSH-së, vendos dhe shpall thirrjen e Kongresit të SPPTSH-së, përcakton normat e përfaqësimit dhe mënyrën e zgjedhjes së delegatëve, brenda kriterëve që përcaktohen në këtë Statut dhe në rregullore të miratuara në SPPTSH. Këshilli Kombëtar i SPPTSH-se miraton dhe i propozon Kongresit, kandidaturat për kryetarin e SPPTSH-së, kur përkëto kanë votuar më shumë se 50% e anëtarëve pjesëmarrës të Këshillit Kombëtar.

Këshilli Kombëtar i SPPTSH-së drejtohet nga Kryetari ose në mungesë të Kryetarit nga zv/Kryetari dhe ka për detyrë:

- a) të drejtojë iniciativa të karakterit të përgjithshëm;
- b) të verifikojë në kompleks aktivitetin sindikalist;
- c) të marrë vendime të karakterit social, ekonomik dhe politik;
- d) të hartojë dhe përcaktojë strategjinë sindikale të organizatës.
- e) të aprovoj buxhetin, bilancet, dhe veprimtarinë financiare vjetore.
- f) të vendos mbi ndarjen,organizimin,bashkimin e strukturave të seksioneve, rajoneve apo filialeve
- g) të miratojë strukturat e propozuara nga Kryetari i SPPTSH-së.
- h) të zgjedhë zv/kryetarin
- i) të zgjedhë sekretarin e organizativ
- j) të zgjedhë Komisionin i zgjidhjes së Konfliktëve dhe Verifikimit te Mandatëve.
- k) të zgjedhë Komisionin e Revizionit dhe Kontrollit
- l) të mandatojë përfaqësuesit e strukturave në pamundësi të mbajtjes së zgjedhjeve
- m) të shpall Kongresin e jashtzakonshëm, kur këtë e kërkojnë mbi dy të tretat e anëtarëve;

Cdo ndryshim miratohet me shumicë votash kur për këtë kanë votuar më shumë se 50% e anëtarëve pjesëmarrës të Këshillit Kombëtar.

NENI 20

Vlefshmëria e mbledhjes së Këshillit Kombëtar

Mbledhjet e Këshillit Kombëtar janë të vlefshme kur janë të pranishëm mbi 50% e anëtarëve të

tij. Ky Këshill mbledhet minimalisht dy herë në vit.

NENI 21 Kryesia e SPPTSH-së

Kryesia e SPPTSH-së, përbëhet nga 9 anëtarë, kryetari, zv/kryetari, Sekretari Organizativ dhe 6 anëtarë. Kryesinë e miraton Këshilli Kombëtar dhe e propozon Kryetari i SPPTSH-së.

Kryesia, drejton, organizon dhe ndjek veprimtarinë për zbatimin e vendimeve të Kongresit dhe të Këshillit Kombëtar. Kryesia organizon gjithë punën organizative, koordinuese dhe teknike të gjithë strukturave të SPPTSH-së, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të aktivitetit sindikal. Ajo ndjek planifikimin dhe zbatimin e strategjisë për kualifikimin dhe trajnimin e të gjithë anëtarësisë sindikaliste sipas programeve të caktuara. Mbledhjet e Kryesisë drejtohen nga Kryetari i SPPTSH-së.

Kryesia vendos për thirrjen e Këshillit Kombëtar dhe përgatit materialet që i paraqiten asaj. Me propozim të Kryetarit, Kryesia vendos për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Këshillit Kombëtar. Në raste të vecanta kryesia mund të vendos për shtyrjen e mbledhje së Këshillit Kombëtar deri në 6 (gjashtë muaj).

Këshilli Kombëtar thirret edhe me kërkesën e ½ së anëtarëve të tij, kërkesë të cilën delegojnë Kryetarit të SPPTSH-së dhe miratohet prej tij.

Ne raste të vecanta, Kryetari i SPPTSH-se për të marrë një vendim sa me kolektiv mund të therras një mbledhje të zgjeruar kryesie edhe me përfaqësues të tjerë të strukturave sindikale.

NENI 22 Kryetari i SPPTSH-se

Kryetari është drejtuesi më i lartë i SPPTSH-së. Ai është përgjegjësi kryesor për drejtimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së përditshme të SPPTSH-së, në zbatim të Statutit, Programit dhe vendimeve të miratuara nga Forumet Drejtuese të SPPTSH-së. Kryetari përfaqëson Sindikatën në veprimtaritë me punëdhënësin, institucionet shtetërore, partitë politike, organizatat shoqërore, sindikatat e tjera, me organizatat e punëdhënësve shtetërorë dhe privatë, me median, shoqërinë civile, etj. si brenda dhe jashtë vendit.

Kryetari, drejton dhe bashkërendon punën me Kryesinë e SPPTSH-së, nënshkruan në emër të sindikatës marrëveshjet me punëdhënësin publik ose privat, me institucionet të tjera shtetërore politikëbërëse dhe vendimmarrëse, me organizatat të tjera sindikale. Ai nënshkruan në emër të strukturave të SPPTSH-së, për të gjithë dokumentacionin shkresor dhe financiar. Kryetari mban qendrim, merr vendime dhe bën deklaratat e prononcime për çështje emergjente që nuk presin dhe vë në dijeni, në mbledhjen më të afërt Kryesinë dhe Këshillin Kombëtar të SPPTSH-së. Ai ndjek zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të caktuara nga Kryesia dhe Këshilli Kombëtar i SPPTSH-së

Kryetari ka për detyrë:

- a) Të udhëheqë deri në zgjedhje drejtimin e SPPTSH-së.
- b) Kryetari është njëkohësisht kryetar i Këshillit Kombëtar dhe drejton mbledhjet e Këshillit Kombëtar të SPPTSH-së. Cdo vendim i Këshillit Kombëtar firmoset prej tij.
- c) të përfaqësojë sindikatën në bisedimet me punëdhënësin për marrëveshjen kolektive, reformat dhe çështje të tjera sindikale.

- d) të drejtoj veprimtarinë dhe aktivitetet e përditshme të SPPTSH-së.
- e) ndjekë ecurinë e buxhetit dhe zbatimin e planeve ekonomike e financiare të sindikatës.
- f) Vendosi për përbërjen e delegacioneve që përfaqësojnë SPPTSH-në, në veprimtaritë kombetare, ndërkombëtare, si dhe për ftesat, që i drejtohen SPPTSH-së, nga sindikatat simotra.
- g) Kryetari nuk mund të largohet më shumë se gjashtë muaj nga posti i tij pa shkaqe të arsyeshme.
- h) Në mungesë kryetari, delegon zv/kryetarin ta përfaqësojë.

Në rast se Kryetari jep doreheqje të parevokueshme, ben thyerje të rënda të statutit, apo vepra të dënueshme nga Kodi Penal, ai zëvendësohet deri në 3 Muaj nga zv/kryetari. Më pas zhvillohet Kongresi i Jashtëzakonshëm, i cili zgjedh kryetarin e ri.

Kryetari ka për detyrë dhe të drejtë të kontrollojë në cdo kohë që e sheh të nevojshme, gjendjen financiare të sindikatës dhe për këtë thërrasin në raport forumet dhe personat e ngarkuar.

NENI 23

Presidenti i Nderit

Presidenti i nderit zgjidhet nga Kongresi me propozim të Kryetarit të SPPTSH-se ose një grupi delegatësh. Presidentit është honorifik dhe keshillues deri në kongresin e ardhshëm. Presidenti i Nderit merr pjesë në konferencat vjetore të organizuara nga Sindikata si dhe mban fjalën përshëndetëse në Kongresin vijues.

NENI 24

Zv/Kryetari dhe Sekretarin e Organizativ

Zgjidhen nga Këshilli Kombëtar i SPPTSH-se me pjesëmarrjen e jo më pak se 50 % të anëtarëve të tij dhe kur për këtë kanë votuar mbi 50% e pjesëmarrësve. Kandidatura dhe numri i zv/kryetarëve propozohet nga Kryetari SPPTSH-së në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar.

Zëvendëskryetari ka për detyrë:

- Të asistojë kryetarin në drejtimin e SPPTSH-së
- Të përfaqësojë Kryetarin në mungesë kur delegohet prej tij
- Të jetë përgjegjës për të mbrojtur të drejtat e punonjësve anëtarë
- Të promovojë sindikatën dhe të rrisë numrin e anëtarëve
- Të iniciojë takime ndërmjet forumeve të SPPTSH-së.
- Të luftojë diskriminimin në vendin e punës

Sekretari ka për detyrë:

- Sekretari i organizativ është zëdhënësi i Sindikatës
- Përgjigjet për të gjitha problemet organizative të sindikatës dhe vë në djeni kryesinë në mënyrë periodike për vijueshmërinë e veprimtarisë organizative dhe merr detyra prej saj.
- Të asistojë kryetarin në drejtimin e SPPTSH deri në zgjedhjet e ardhshme
- Të organizojë dhe kordinojë mbledhjet e Këshillit Kombëtar të SPPTSH
- Të përgatisë raportet vjetore
- Informimi e anëtarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e Sindikatës

NENI 25

Organe te tjera

Komisionin i zgjidhjes së Konfliktëve dhe Verifikimit të Mandateve perbehet nga pesë anëtarë dhe zgjidhen nga Kongresi. Komisioni përgjigjet për të drejtat e anëtarëve, si dhe për juridiksionin e brendshëm të SPPTSH-së. Ai ka të drejtë të pezullojë cdo vendim që ka marrë struktura sindikale dhe ta kthejë atë për rishqyrtim. Ky komision për cdo konflikt të lindur dhe zgjidhjen ose jo të tij nofton kryesinë dhe jep verdiktin e tij pas miratimit nga kryetari i SPPTSH-së

NENI 26

Komisioni i Kontroll-Revizionit Financiar përbëhet nga pesë anëtarë dhe votohet nga Kongresi. Ai drejtohet nga kryetari i tij i cili propozohet nga kryetari i SPPTSH-së dhe miratohet nga Këshilli Kombëtar. Harton programet e kontrollit dhe miraton ato tek Kryetari i SPPTSH-së. Kontrollon periodikisht financën dhe dokumentat financiare të SPPTSH-së dhe organizatave sindikale. Raporton në Këshillin Kombëtar për kontrollet e kryera.

NENI 27

Forumi i gruas dhe Forumi i Rinisë

Forumi i gruas ka si qëllim

- Të inkurajojë dhe te promovojë pjesëmarrjen e grave në Sindikatë
- Të raportojë në Këshillin Kombëtar në çështje të ngritura në forum
- Të punojë për promovimin dhe mbrojtjen e interesave të grave
- Organizon aktivitete edukative dhe rrit njohuritë e tyre për ruajtjen e vendit të punës dhe rolin e saj në sindikate.
- Lufton për sigurimin e barazisë gjinore në strukturat sindikale dhe harmonizimin e gruas në postet drejtuese të kompanisë.
- Siguron kushte lehtësuese të gruas në punë dhe në zgjidhjen e problemeve familjare të saj si akomodimi i femijëve të mitur, etj
- Organizon konferencën e Gruas

Forumi i Rinisë ka si qëllim:

- Të mbrojë dhe promovojë interesat e punonjësve nën 35 vjeç
- Sugjeron Këshillin kombëtar për çështje që kanë lidhje me Rininë
- Promovon të rinjtë në drejtimin e SPPTSH-se.
- Lufton për punë të denjë dhe paga të denjë për rininë
- Kërkon promovimin e të rinjve në drejtimin e sektoreve të kompanisë.
- Kërkon Pjesëmarrje të rinisë në veprimtaritë e sindikates dhe trajnime të organizuara prej saj.
- Organizon konferencën e Rinisë

Kandidaturat për këto forume rekomandohen nga Kryetari i Këshillit Kombëtar.

NENI 28

Këshilli Kombëtar i SPPTSH-së është forumi që vendos përfundimisht çështjet e diskutuara, të cilat i ka pezulluar Komisioni Konfliktëve.

NENI 29 Aksioni sindikal

Vendimet e cdo forme të aktivitetit sindikalist dhe vecanërisht për greven janë kompetence e organizatave të interesuara. Aksioni sindikalist fillon nga forma e thjeshtë deri tek greva kur:

- a) Tërheq verejtje dhe zhvillon bisedime me subjektet kontraktuese.
- b) Bën kërkesë me shkrim për respektimin e kontratës kolektive të punës dhe te normave ligjore.
- c) Ngre padi pranë organeve përkatëse të drejtësisë .
- d) Percakton afatin e zgjidhjes së konfliktit.
- e) Merr vendimin për fillimin e punës.

NENI 30 Greva

Është mjet i fuqishëm demokratik në luftë për të realizuar të drejtat që burojnë nga legjislacioni shqiptar mbi marrëdhëniet e punës dhe kontratave kolektive të punës dhe në shenjë solidariteti për të përkrahur sindikatat e tjera kur është e nevojshme.

Greva fillon kur janë konsumuar të gjitha përpjekjet për marrëveshje mes palëve, por gjithmonë në respektimin e procedurave dhe ligjit mbi grevat.

NENI 31

Greva fillon kur atë e votojnë mbi 50% e anëtarëve të sindikatës së sistemit.

NENI 32

Greva drejtohet nga Komisioni i Grevës, i zgjedhur nga vetë grevistët. Përfaqësuesit e organizatës sindikale ne filial duhet të jenë në kryesinë e komisionit të grevës së sindikatës, por nuk mund të jenë kryetarë greve.

- a) Greva ndërpritet pasi përmbushen kushtet e vendosura nga grevistët.
- b) Kur arrihet kompromisi nga te dy palet.
- c) Greva ndërpritet gjithmonë me pëlqimin e grevistëve.

NENI 33

Greva ne sistemin e Postave dhe Telekomit shqiptar zhvillohet konform ligjit "Mbi grevat në Republikën e Shqipërisë".

NENI 34 Shkrirja e SPPTSH-së

Shkrirja e SPPTSH-se mund të bëhet vetem nga Kongresi i saj me një shumicë tre të katërtat e votave të delegatëve.

NENI 35
Vlefshmëria e Statutit

Ky statut hyn ne fuqi menjëherë pas depozitimit në Gjykatën e Tiranës dhe Ministrinë e Punës. Nenet e këtij statuti janë detyruesisht të zbatueshme për të gjithë anëtarësinë dhe strukturat e SPPTSH-së deri në ndryshimin e mundshëm nga Kongresi. Për rastet tepër të vecanta, të paparashikuara në statut mund të amendohet statuti dhe kur ketë e vendos Këshilli Kombëtar me votim prej tre të katërtave të anëtarëve të tij.

NENI 36
Rregullat e brendshme te Kongresit

Kongresi zakonisht hapet nga President i Nderit ose nga nje sindikalist i vjeter dhe do te drejtohet nga Kryetari deri ne zgjedhje. Seanca e parë fillon me fjalën e Kryetarit. Në vazhdim behen përshëndetjet nga të ftuarit dhe kryesia i jep pergjigje pyetjeve me shkrim rreth raportit. Kryesia cakton kohën e punës dhe pushimit mes seancave. Kryesia ka të drejtë të hartojë rezoluten e Kongresit dhe ta paraqesë atë për miratim. Kryesia mund të përfshijë propozime dhe rezoluta ne rendin e ditës së Kongresit, si përpara, ashtu dhe gjatë punimeve të tij.

Gjatë Kongresit, propozimet emergjente dhe rezolutat mund të formulohen me shkrim dhe mund të paraqiten të paktën nga 30 % e delegateve të pranishëm. Delegatët që dëshirojnë të diskutojnë në Kongres duhet të paraqesin dokumentat e tyre me shkrim në sekretari. Asnjë diskutant nuk mund t'i drejtohet Kongresit dy herë për të njëjtën çështje. E drejta e fjalës për cdo diskutant do të jetë jo më shumë se 5 minuta. Kryesia miraton listën e përfaqësuesve që përshëndesin Kongresin. Diskutimet mbyllen me propozimet e bëra nga delegatët, ose kryetaret e seancave dhe me miratimin e më shumë së gjysmës së delegatëve të Kongresit.

Komisioni i Votimit, zhvillon procedure e votimit per Kryetarit e SPPTSH-se. Menyra e votimit eshte e fshehtë ose e hapur e votuar nga delegatët. Në rast se për kryetarin e SPPTSH-së është paraqitur vetëm një kandidaturë komisioni votimit i propozon delegatëve për mënyrën e votimit të fshehtë apo të hapur. Komisioni votimit në bazë të votave të delegatëve procedon memënyrën e votimit që ka marrë më shumë vota.

Rregullat e brendshme të Kongresit mund të ndryshohen dhe miratohen paraprakisht nga Këshilli Kombëtar jo më pak se 1 (një) muaj, para se ai te zhvillohet.

NENI 37

Me zgjedhjen e organeve drejtuese të SPPTSH-së në Kongres, Kryetari bën betimin para delegatëve të Kongresit.